



Buletini i Turizmit

Raportim Mujor

Shkurt 2023

PËRMBAJTJA

HYRJE

- 1. VIZITORË TË HUAJ TË HYRË PËR MUAJIN SHKURT 2023..... fq.3**
 - 1.1. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve**
 - 1.2. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit**
 - 1.3. Hyrja e shtetasve të huaj sipas mënyrës së udhëtimit**

- 2. TURIZMI KULTUROR.....fq.5**

- 3. TURIZMI NATYROR..... fq.7**

1. HYRJET E VIZITORËVE TË HUAJ PËR MUAJIN SHKURT 2022

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 309.325. Ky numër është rritur me 53,9 %, krahasuar me Shkurt 2022.

Gjatë dymujorit të parë 2023, numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 686.536. Ky numër është rritur me 73,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2022.

| Periudha | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Ndryshimi në (%) | Janar-Shkurt 2022 | Janar – Shkurt 2023 | Ndryshimi në (%) |
|------------------|-------------|-------------|------------------|-------------------|---------------------|------------------|
| Vizitorët e huaj | 200,997 | 309,325 | 53,9 | 395,234 | 686,536 | 73,7 |

1.2. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Referuar qëllimit që deklarojnë shtetasit e huaj, që vizitojnë Shqipërinë, rezulton se në Shkurt 2023, krahasuar me Shkurt 2022, hyrjet e shtetasve të huaj janë rritur:

- për qëllime personale me 55,8 %;
- për qëllime pushime, vizitë tek të afërm, etj. me 54,3 %;
- për biznes dhe qëllime profesionale me 6,3 %

Më poshtë është tabela e vizitorëve të huaj sipas qëllim të vizitës së tyre, që deklarojnë në pikat tona kufitare:

| Periudha | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Ndryshimi në (%) | Janar Shkurt 2022 | Janar Shkurt 2023 | Ndryshimi në (%) |
|-----------------------------------|-------------|-------------|------------------|-------------------|-------------------|------------------|
| Gjithsej | 200.997 | 309.325 | 53,9 | 395.234 | 686.536 | 73,7 |
| I. Personale | 193.087 | 300.913 | 55,8 | 381.118 | 670.519 | 75,9 |
| Pushime, miq e të afërm. Te tjere | 185.508 | 286.283 | 54,3 | 365.479 | 639.035 | 74,8 |
| Trajtime shëndetësore | 103 | 40 | -61,2 | 238 | 155 | -34,9 |
| Qëllime fetare | 16 | 37 | 131,3 | 45 | 58 | 28,9 |
| Tranzit | 7.460 | 14.553 | 95,1 | 15.356 | 31.271 | 103,6 |

| | | | | | | |
|-----------------------------|-------|-------|-----|--------|--------|------|
| II. Biznes dhe profesionale | 7.910 | 8.412 | 6,3 | 14.116 | 16.017 | 13,5 |
|-----------------------------|-------|-------|-----|--------|--------|------|

Burimi INSTAT 1.3. Hyrja e shtetasve të huaj sipas qëllimit të udhëtimit

Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Shkurt 2022, janë 695.246. Krahasuar me Shkurt 2022, ky tregues rezulton me një rritje 51,5%. Në këtë muaj, udhëtimi me mjete ajrore kanë një rritje 58%, por gjithsesi udhëtimi me rrugë tokësore mbetet udhëtimi më i preferuar për vizitorët e huaj dhe shqiptarë.

Në lidhje me raportin e mënyrës së transportit të zgjedhur nga vizitorët e huaj për të hyrë në Shqipëri në muajin Shkurt 2023, numri i hyrjeve në total të vizitorëve të huaj dhe vendas, i shprehur në %, është si më poshtë:

- i. 72,6 % e të huajve dhe vendasve zgjedhin rrugën tokësore për të hyrë në Shqipëri;
- ii. 24,5 % e të huajve dhe vendasve hyjnë në kufirin shqiptar në rrugë ajrore;
- iii. 2,9% e hyrjeve bëhet nëpërmjet transportit detar.

Në tabelën më poshtë jepet lloji i udhëtimit të shtetasve të huaj dhe shqiptarë, që kanë zgjedhur gjatë muajit Shkurt 2023, krahasuar kjo me të njëjtin muaj të vitit 2022:

| | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Ndryshimi në % | Janar-Shkurt 2022 | Janar-Shkurt 2023 | Ndryshimi ne % |
|---------|-------------|-------------|----------------|-------------------|-------------------|----------------|
| Me ajër | 107.911 | 170,413 | 58% | 216.244 | 361,157 | 67% |
| Me det | 18.696 | 19,941 | 7% | 36.147 | 40,805 | 13% |
| Me tokë | 332.344 | 504,892 | 52% | 660.632 | 1,189,275 | 80% |

Burimi INSTAT

1.4 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas shteteve

Në Shkurt 2023, vijon që numri i shtetasve Kosovar të jenë vizitorët që preferojnë më shumë të vizitojnë Shqipërinë, gjatë këtij muaji shohim një rritje të konsiderueshme krahasuar me vitin paraardhës. Gjithashtu numrin më të madh të vizitorëve të huaj në këtë periudhë e kemi nga Mali I Zi, Italia e Maqedonia.

Më poshtë gjeni tabelën e hyrjes të vizitorëve të huaj për nga shtetësia:

| Shtetet | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Ndryshimi në (%) | Janar-Shkurt 2022 | Janar-Shkurt 2023 | Ndryshimi ne % |
|---------------------------|----------------|----------------|------------------|-------------------|-------------------|----------------|
| Kosovë | 65.097 | 121,617 | 87% | 128.464 | 287,949 | 124% |
| Maqedonia e Veriut | 27.765 | 32,516 | 17% | 60.323 | 76,106 | 26% |
| Greqi | 23.191 | 31,889 | 38% | 42.152 | 67,018 | 59% |
| Itali | 22.927 | 33,622 | 47% | 44.208 | 69,232 | 57% |
| Angli | 6.100 | 7,807 | 28% | 10.686 | 14,305 | 34% |
| Mali i Zi | 22.927 | 34,341 | 50% | 44.257 | 74,050 | 67% |
| Poloni | 620 | 961 | 55% | 1.090 | 1,825 | 67% |
| SHBA | 3.079 | 4,746 | 54% | 6.701 | 10,244 | 53% |
| Spanjë | 774 | 1,053 | 36% | 1.379 | 1,951 | 41% |
| Gjermani | 3.486 | 4,547 | 30% | 7.003 | 9,566 | 37% |
| Zvicër | 1.426 | 1,728 | 21% | 3.011 | 3,754 | 25% |
| Totali | 200.997 | 309,325 | 53,9% | 395.234 | 686,536 | 74% |

Burimi Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

2. TURIZMI KULTUROR

Për mujin shkurt 2023, 12,562 vizitorët kanë vizituar 28 Institucionet e Kulturës ose 20% më shumë vizitorë se i njëjti muaj i vitit 2022. Numri i vizitorëve që kanë vizituar "Muzeumet" gjatë muajit të dytë të vitit është rritur me 27 % krahasuar me shkurt 2022; Vizitorët në "Kala dhe Monumente të tjera" është rritur me 4%; ndërsa numri i vizitorëve në "Parqet Arkeologjike" është rritur 32 % më shumë.

Më poshtë po japim tabelën e vizitueshmërisë së institucioneve të kulturës për muajin shkurt e krahasuar dhe me dy vitet paraardhëse.

| INSTITUCIONET E KULTURËS | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | Ndryshimi në % | Janar- Shkurt 2022 | Janar- Shkurt 2023 | Ndryshimi në % |
|---|----------------|----------------|-------------------|--------------------------|--------------------------|-------------------|
| MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË | 714 | 1,443 | 102% | 1,069 | 3,021 | 183% |
| MUZEU ARKEOLOGJIK DURRËS | 281 | - | 0% | 445 | - | -100% |
| MUZEU I PAVARSISË VLOREË | 97 | 163 | 68% | 114 | 285 | 150% |
| MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUJË | 1,196 | 1,489 | 24% | 2,562 | 3,324 | 30% |
| MUZEU ETNOGRAFIK, KRUJË | 194 | - | -100% | 417 | - | -100% |
| MUZEU ETNOGRAFIK BERAT | 122 | - | -100% | 275 | - | -100% |
| MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT | 466 | 622 | 33% | 914 | 1,762 | 93% |
| MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË, | 174 | 250 | 44% | 351 | 644 | 83% |
| MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË, | 61 | 66 | 8% | 70 | 153 | 119% |
| MUZEU ARSIMIT, KORÇË, | 564 | 707 | 25% | 1,133 | 1,489 | 31% |
| MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI | 357 | 320 | -10% | 567 | 734 | 29% |
| MUZEU K. I PËRGJIMEVE " SHTËPIA ME GJETHE" | 853 | 1,374 | 61% | 1,469 | 2,344 | 60% |
| TOTALI MUZE | 5,079 | 6,434 | 27% | 9,386 | 13,756 | 47% |
| KALAJA BERAT | 747 | - | -100% | 4,582 | - | -100% |
| KALAJA GJIROKASTËR | 1,015 | 1,722 | 70% | 1,802 | 4,392 | 144% |
| KALAJA PORTOPALERMOS | 20 | 24 | 20% | 28 | 38 | 36% |
| KALAJA E KANINËS | 7 | 33 | 371% | 17 | 33 | 94% |
| KALAJA E HIMARËS | 9 | - | -100% | 17 | - | -100% |

| | | | | | | |
|---|---------------|---------------|------------|---------------|---------------|-------------|
| AMFITEATRI I DURRËSIT | 227 | 271 | 19% | 371 | 466 | 26% |
| MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE | 2 | 49 | 2350% | 4 | 54 | 1250% |
| TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE | 2,027 | 2,099 | 4% | 6,821 | 4,983 | -27% |
| PARKU KOMBËTAR BUTRINT | 362 | 729 | 101% | 747 | 1,159 | 55% |
| PARKUT ARKEOLOGJIK APOLONI | 670 | 808 | 21% | 1,344 | 2,359 | 76% |
| PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS | 87 | 104 | 20% | 223 | 213 | -4% |
| PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR | 1,746 | 2,217 | 27% | 4,085 | 4,798 | 17% |
| PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË | 174 | 134 | -23% | 361 | 296 | -18% |
| PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA | 5 | - | -100% | 6 | 4 | -33% |
| PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM | 10 | 34 | 240% | 14 | 69 | 393% |
| PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ | 2 | 3 | 50% | 2 | 19 | 850% |
| PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE | - | - | 0 | - | 31 | |
| TOTALI PARQE ARKEOLOGJIK | 3,056 | 4,029 | 32% | 6,782 | 8,948 | 32% |
| TOTALI I VIZITOREVE | 10,162 | 12,562 | 24% | 22,989 | 27,687 | 20% |

Burimi Ministria e Kulturës

Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në Institucionet Kulturore për këtë muaj rezulton që të jenë përfituar rreth 3,764,820, vlerë që është rritur në masën 36,6 % krahasuar me të njëjtin muaj të vititi 2022.

4. TURIZMI NATYROR

Të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se gjatë muajit shkurt 2023 kemi 99,422 vizitorë vendas dhe të huaj, që kanë vizituar zonat tona të mbrojtura. Gjatë këtij muaji vihet re një rënie prej 63% krahasuar me muajin

shkurt të vitit 2022. Shkak i kësaj rënie është ulja e numrit të vizitorëve në zonës e Korçës, Kukësit dhe Beratit.


Më poshtë po japim numrin e vizitorëve sipas Qarqeve e krahasuar me të njëjtat periudhë të një viti më parë:

| QARKU | Shkurt 2022 | Shkurt 2023 | NDRYSHIMI NE % | Janar-Shkurt 2022 | Janar-Shkurt 2023 | Ndryshimi në % |
|---------------|----------------|---------------|----------------|-------------------|-------------------|----------------|
| Tirana | 5,934 | 7,602 | 20% | 13,262 | 16,630 | 28% |
| Vlora | 6,644 | 9,722 | 2% | 17,447 | 17,852 | 46% |
| Lezhë | 4,135 | 5,432 | 26% | 7,899 | 10,727 | 31% |
| Gjirokastrë | 2,394 | 3,931 | 44% | 4,200 | 7,557 | 64% |
| Kukës | 1,125 | 405 | -199% | 2,150 | 720 | -64% |
| Korçë | 98,154 | 15,359 | -575% | 198,562 | 29,424 | -84% |
| Berat | 1526 | 898 | -17% | 2,833 | 2,431 | -41% |
| Elbasan | 2,449 | 2,600 | -8% | 5,450 | 5,061 | 6% |
| Shkodër | 2,550 | 13,480 | 63% | 9,550 | 25,990 | 429% |
| Dibër | 431 | 3,993 | 93% | 737 | 10,405 | 826% |
| Fier | 13,400 | 16,000 | 23% | 26,100 | 34,000 | 19% |
| Durrës | 16,100 | 20,000 | 17% | 27,150 | 32,600 | 24% |
| TOTALI | 154,842 | 99,422 | -63% | 315,340 | 193,397 | -36% |

Burimi: Agjensia e Zonave të Mbrojtura


Për të parë se cilat kanë qënë Zonat e Mbrojtura më të vizituara gjatë muajit shkurt po e japim me paraqitje grafike sipas kategorive.

Kategoria e **Parqeve Natyrore** ka 12 zona të cilat janë vizituar nga 38,301 vizitorë, prej tyre 88.8% janë vizitorë vendas dhe 11.2% vizitorë të huaj. Numri më i madh i vizitorëve për këtë kategori është në Parkun Kombëtar të Divjakës- Karavasta (37%) dhe e dyta për nga vizitueshmëria këtë muj është Mali i Dajtit dhe më pas është në Alpet e Shqipërisë nga pjesa e Shkodrës.




Në kategorinë **Monumentet e Natyrës**, janë të shpallura 30 zona, të cilat gjatë Shkurtit ka pasur vizitorë vetëm në 21 prej tyre zona të cilat janë vizituar prej 15,188 vizitorë. Nga këta 91% janë vizitorë vendas dhe 9% vizitorë të huaj. Vizitorët me numrin më të madh janë në Monumentin e Natyrës Sarisalltik të Krujës (25% e vizitorëve), e cila ndiqet nga Kepi i Rodonit (24%) dhe Shpella e Shënandoit (17%). Më poshtë po japim në mënyrë grafike numrin e vizitor në grafikun më poshtë:

Vizitorët Monumentet e Natyrës




- Kanionet e Osunit
- Kepi Rodonit
- Shkëmbi i Kavajës
- Rrapi i Ballabanecit
- Selvia Fushë - Krujë
- Sarisalltik
- Rrepet e Byshekut
- Liqeni Seferanit
- Pisha Fushëkuqes
- Kanioni i Sinecit
- Ujëvara e Sotirës
- Pylli Kalasë së Tunjës
- Kanioni i Holtës
- Moçalet e Grabovës
- Liqeni i Dushkut
- Shpella Shënandoit
- Kroi i Bardhë
- Pylli i Shënmerisë
- Rëra e Hedhur
- Ujrat termale të Bënjës
- Pylli i fazanëve

Në kategorinë **Rezervatet Natyrorë të Menaxhuar dhe Parqet Natyror** Monumentet e Natyrës janë të përfshira 24 zona, por vetëm në 19 prej tyre ka pasur vizitorë për muajin shkurt 2023. Numri i vizitorëve për këtë kategori është 27,633, nga këta, ku 92% janë vizitorë shqipëtar. Numrin më të madh të vizitorëve e ka Qafshatama (34%) e ndjekur nga Liqeni i Shkodrës (29%).



- Karaburun
- Syri i Kaltër
- Cangonj
- Gërmenj
- Dardhë - Xhyrë
- Kune -Vain -Tale dhe Patok - Fushëkuqe - Ishëm
- Munellë
- Korab - Koritnik
- Liqeni i Ulzës
- Korab-Koritnik
- Mali me Gropa - Bizë - Martanesh
- Mali me Gropa - Bizë - Martanesh
- Liqeni Shkodrës
- Munellë
- Lugina e Shalës
- Bredhi i Sotirës
- Zagori
- Qafshatamë

Në kategorinë **Peisazh I Mbrojtur** përfshihen 11 zona, por për muajin janar, ka pasur vizitor vetëm në 7 zona. Numri i vizitorëve që kanë vizituar këto 7 zona është 18,300, nga ku 87.1 % e vizitorëve janë shqiptarë. Vizitorët me numrin më të madh janë në Peisazhin e Mbrojtur të Liqenit të Pogradecit (52%), të ndjekur nga vizitorët në Lumin Buna e Nartë Pishë Poro.



Sipas Agjensisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, të ardhurat, për zonat ku vizitorët paguajnë, për muajin Janar llogaritet që është përfituar një vlerë prej 170,900 Lek.